



Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus + në University of Chieti, Itali

Në kuadër të Marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në University of Chieti, (Università degli Studi "G. d'Annunzio" Chieti - Pescara), Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master (viti 4 ose 5), për studime;
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master, (viti 5), për Traineeship;
- Shkëmbimin e stafit, për mësimdhënie.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Master** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në profilin Arkitekturë apo Urbanistike, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës.)
- **Staf, për mësimdhënie.**

Kohëzgjatja e bursave:

- Studime – 6 muaj, semestri i I, 2021 – 2022;
- Traineeship – 3 muaj, semestri i II, 2021 – 2022;
- Staff, teaching - 15 ditë.

Fushat e studimit:

Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

Numri total i studentëve dhe stafit për mobilitet:

Për studime: 2 studentë; (1 student Arkitekture, 1 student Urbanistike);

Për Traineeship: 2 studentë; (1 student Arkitekture, 1 student Urbanistike);

Për mësimdhënie: 2 staff.



Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash të studimeve Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master, deri në momentin e aplikimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj* (Italisht ose Anglisht);
- Dokumenti Learning Agreement**.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Dokumenti Staff Mobility for Teaching Mobility Agreement;
- Niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. (Italisht ose Anglisht).

*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj. Preferohen: TOEFL iBT Certificate, Cambridge Certificate, IELTS Certificate.

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në University of Chieti lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni më poshtë:

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:

Deri më 15 Maj 2021



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Key Action 1
- Mobility for learners and staff -



Për informacione në lidhje me lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës dhe plotësimin e dokumentacionit, ju lutemi, kontaktoni me:

PhD. Arch. Loreta Çapeli
Zv. Dekan
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
Email: loretacapeli@hotmail.com

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al dhe abeqo@upt.al